


### Hapi 1 Menyrë e thjeshtë për të montuar Benzing Ekspres G2 dhe për ta lidhur me antenën e kafazit

- Lidh sëbashku antenat (pedanat) BENZING G2
  - Për 1-Field G2 Antenat (C) duke përdorur kabllin e rritësit BENZING G2 25 cm (F).
  - Për 4-Field G2 Antenat (B) përdorin kablo bashkangjitur tashmë e antenave me një antenë (E).
- Lidhni BENZING Ekspres G2 (A) me ane te kabllit fig (D) me antenën e parë BENZING G2 Antenna.
- Lidh ushqysin e rrymës (adaptorin) me hyrjen Sub-D-9 të BENZING Express G2 (D).
- Fusni ushqyesin (adaptorin) fig (G) në burimin kryesor të energjisë.



- (A) Ora e Benzing Ekspres G2
- (B) 4-Field Antenat (Pedanat) BENZING G2
- (C) 1-Field Antenat (Pedanat) BENZING G2
- (D) Kablli lidhës i gjatë 5 m
- (E) Kabllot lidhja e antenave 4-Field BENZING G2 (fix)
- (F) Kablli I rritësit BENZING G2 (25 cm)
- (G) Ushqyesi (burimi) i energjisë
- (H) Kontrolluesi Antenave Benzing
- (I) Antena e kafazit të pellumbave (EFA)

#### Antenat BENZING G2:

Antenat (pedanat) BENZING G2 mund të montohen direct pranë njëra tjetrës (si tregohen në figure ) ose me anë të kabllit PLB USC (deri në 50 m / 160 feet).

Antenat (pedanat) 4-Field BENZING G2 duhet të montohen me distancë me njëri-tjetrin (min. 1 m).

Për më tepër informacion shih fletën e instruksioneve të përfshirë brenda në kutinë e antenave (pedanave) BENZING G2.


Deri në 5 Antenat BENZING G2 mund të jetë i lidhur.

#### Sistemet e vjetra:

Antenat (pedanat) e modelit më të vjetër EFA mund të përdoren gjithashtu me orat BENZING Express G2. Në këtë rast përdoret kontrolluesi i antenave BENZING, siç treguhet në figurën e mësipërme. Për më tepër informacion shihni fletën e instruksionit të kontrolluesit të Antenave BENZING Antenna Controller.

### Hapi 2 Funkionimi dhe menuja kryesore

Pas lidhjes me linjën kryesore në ekran do të shfaqet logoja e Benzing me të gjitha versionet e programeve të instaluar në të. Pas kësaj ora do të kontrollojë të gjitha pajisjet e lidhura para se të shfaqë menunë kryesore.



#### Emri i rritësit:

Këtu emri i rritësit do të shfaqet vetëm pasi të jetë bërë rregjistrimi i tij një herë në softuer (bazën e të dhënave).

#### Koha:

Në këtë pjesë tregohet ora. Kini parasysh që koha që do të tregohet është gjithmonë e sakte. Koha vendoset nga Qendra ose mund të vendoset duke patur parasysh udhëzimet shtesë që janë në fund.

#### Zonë informimi :

Kjo është zona kryesore që shfaqet në ekran. Nëse gara apo stërvitja është duke u zhvilluar mbërritja e pellumbave do të tregohet. Për të kontrolluar përmes kësaj liste mund të përdorni dy butonat e mesit (shikoni hapin 3).

#### Lidhjet me antenat e kafazeve :

Në këtë seksion do të tregohen numri total i antenave. Këto antena do të njihen automatikisht kur Ekspres G2 të lidhet me linjën kryesore.


**Shënim:** Kur përdorim pedanat EFA me kontrolluesin e antenave BENZING një dritë e vogël që do të ndizet në Kontrolluesin e Antenave Benzing do të tregojë se antenat e kafazeve janë duke punuar.

#### Mbërritja e pellumbave:

Në këtë pjesë do të tregohen të gjitha rastet e garave si dhe të stërvitjeve të pellumbave të mbërritur.


### Hapi 3 Stërvitja dhe gara

#### Fillimi i një fluturimi stërvitjeje




Në ekran do të shfaqet mesazhi "Stërvitje aktive"ndërsa në Linjën-Infomuese do të tregohet "TRA".

**Shënim:** Nëse një garë po zhvillohet, mesazhi "Garë aktive" do të shfaqet në ekran si dhe do të tregohet simboli i pellumbave (P).



#### Shfaqja në ekran e Informacionit të mbërritjes gjatë një stërvitjeje ose një gare:


Koha e mbërritjes do të tregohet në menunë e informimit e cila do të shfaqet në krye të ekranit ,kur pellumbi të skanohet nga antena.



Në menunë e informimit karakteri i fundit i vijës së parë do të tregojë pellumbin e përzgjedhur për një stërvitje apo për një garë.


"T" = Pellumbi është përzgjedhur për një fluturim stërvitor.  
"1".. "8" = Pellumbi është përzgjedhur për garën nën nr e treguar.

Të gjithë pellumbat e mbërritur do të tregohen në listën e mbërritjes, e cila ndodhet poshtë menusë së informimit për pellumbin e fundit të mbërritur.



Kur ju shtypni butonin e kuq lista do të kthehet mbrapsht automatikisht duke treguar pellumbin e fundit të mbërritur.

#### NDALIMI I NJE STËRVITJEJE



Mbani shtypur butonin e kuq për të paktën 3 sekonda dhe ju do të mund të ndaloni një fluturim stërvitor.

## Të dhëna shtesë

Të dhënat shtesë të treguara në këtë pjesë nuk janë të nevojshme për funksionimin e Benzing Ekspres G2. Sidoqoftë ju mund të ndryshoni disa të dhëna në këtë menu.

Në mënyrë që të ndryshoni disa të dhëna në menu ,ju duhet të shtypni në të njëjtën kohë butonin jeshil dhe të kuq për 3 sekonda.

Në të njëjtën mund të përzgjidhen kohë menu të ndryshme. Këto menu (lista) tregohen grafikisht si më poshtë.



Me anën e 2 butonave të mesit ju mund të shëtisni nëpër listën e opsioneve.

Menuja e përzgjedhur, shfaqet gjithmonë në qendër të ekranit, e futur në një drejtkëndësh të zi.

Kur ju shtypni butonin jeshil mbi menunë që ju vetë keni zgjedhur ajo do të hapet menjëherë. Në përgjithësi butoni jeshil simbolizon shenjën "OK", e cila përdoret për të konfirmuar opsionin e përzgjedhur.


Me anë të butonit të kuq (shenja kthyesë) menunë e përzgjedhura do të mbyllet duke u kthyer në menunë kryesore. Përveç kësaj ajo gjithashtu do të përdoret për të fshirë menunë e përzgjedhur ose zgjedhjet e bera duke e lenë menunë në të cilën kemi kryer këto veprime ,pa i ruajtur ato.

### 1.PËLLUMBAT



Këtu do të tregohen pëllumbat të cilët kanë unaza-cipe dyfishe të vendosura në Benzing Ekspres G2.


Shteti Qendra Viti Numeri i pëllumbit Gjinia



Numeri total i pëllumbave  
Numeri i unazës elektronike Ngjyra  
Pozicioni i pëllumbit të zgjedhur


Nëse asnjë garë nuk po zhvillohet dhe ju përzgjidhni një pëllumb,ju mund ta fshini veprimin e bërë duke shtypur këtë shenjë për 3 sekonda.

### 2. DATA/KOHA




DD=Dita , MM=Mujaji YY= Viti  
hh= Ora, mm = Minutat, ss = Sekondat  
Pozicionimi i kursorit

Data dhe ora aktuale do të shfaqen në ekran. Nëse kursori do të gohet në vendin që ju do të doni të ndryshoni, ai vend do të shenjohej me një vijë të zeze të trashë poshtë.





Me anë të dy butonave të mesit ju mund të rrisni ose zvogëloni numrat për të arritur kohën (orën) e dëshiruar.




Kursori mund të lëvizë djathtas duke shtypur butonin jeshil.

Pasi kursori arrin në fund,pra te sekondat ju mund të shtypni butonin e djathtë duke arritur kështu të bëni ndryshimet e nevojshme.



Ndryshimet e bëra në datë dhe kohë mund të ruhen duke shtypur butonin jeshil.




Nëse ndryshimet e bëra nuk doni që ti ruani,në cdo kohë mund të shtypni butonin e kuq.


### 3.SISTEMI




Këtu ju mund të merrni informacion rreth Benzing Ekspres G2.



Me anë të butonit që ndodhet në krah të djathtë ju mund të përshtasni volumnin e sinjalit si dhe kontrastet e ekranit.



Kursori  
Volumi i sinjalit  
Kontrasti I ekranit  
Treguesi



Së pari me anë të "shigjetes për lartë/poshtë" ju mund të lëvizni dhe të shkoni te volumi apo kontrasti. Me anë të shigjetës djathtas volumi dhe kontrasti mund të ngrihen shkallë-shkallë. Nëse treguesi është në maksimum, ajo do të fillojë sërish nga e majta.


Të dhënat mund ti konfirmoni me anë të butonit jeshil,ose mund të hiqni dorë nga ndryshimet e bëra me anë të butonit të kuq.

### 4. ANTENA



Me anën e kësaj menuje ju mund të shikoni në ekran të gjitha antenat e lidhura. shfaqja në ekran varet nga antenat e lidhura.

**Antenat BENZING G2:**




Numeri Serial i G2 antenna  
Version i programit dhe i antenës G2  
Antenat e shfaqura aktualisht G2 dhe numri total i Express G2  
Antena BENZING G2  
 = Antena është e lidhur  
 = Testi i antenës është në rregull

Rrethi në këndin e majtë poshtë simbolizon antenën BENZING G2 të lidhur rishitas (e cila tregohet në këndin e poshtëm djathtas). Nqs antenna është e lidhur, një pikë tregohet në rreth.

**Kontrolluesi Antenave me antenat e kafazeve EFA:**

numrat serialë të programe ve dhe harduereve të kontrolluesit të antenave 1 numrat serialë të programe ve dhe harduereve të kontrolluesit të antenave 2



Antenat e kafazeve  
 = Antena është e lidhur  
 = Testi i antenës është në rregull


Për antenat EFA, tregohen të katërta antenat e mundëshme për secilin kontrollues Antenash. Antenat e lidhura do të shënohen me anë të një pike brenda rrethit.

Për të parë se si funksionon antenë e një kafazi ju mund të mbani një unazë-chip Benzing Pro mbi të. Nëse ju do të dëgjoni një sinjal atëherë ajo është njohur nga kjo antenë dhe kështu në rrethin përkatës do të shënohet shenja "X".


### 5.PRINTIMI




Pëllumbat e përshtatur me unaza-chip dhe pëllumbat e mbërritur mund të printohen nën këtë opsion.



Në mënyrë që ju të printoni listën e dëshiruar,më parë ju duhet të keni të lidhur një printer me Benzing Ekspres G2. Kjo mund të realizohet vetëm nëse ju përdorni një CPN ose e lidhni Benzing Ekspres G2 me një PC në të cilin duhet të jetë instaluar një printer.



Me anë të 2 butonave të mesit ju mund të zgjidhni listën që dëshironi të printoni.




Me anë të butonit jeshil, ju mund të printoni listën e perzgjedhur nga ju.


**Lista Përshtatja me Chip-at:** Të gjithë pëllumbat që janë përshtatur me Chip-a mund të printohen.

**Lista e mbërritjes:** Të gjithë pëllumbat të cilët kanë mbërritur në kafazin tuaj mund të printohen.


### 6. FSHIRJA E LISTËS



Pasi gara ka përfunduar dhe është vlerësuar në shoqatë,ajo mund të fshihet nga lista. Vetëm pasi gara të jetë fshirë pëllumbat e përzgjedhur për atë garë, mund të jenë sërish të lirë, për tu përzgjedhur për një garë tjetër. **Shënim:** Nëse në një moment të caktuar nuk po zhvillohet asnjë garë,në ekranin tuaj do të shfaqet një mesazh që do tju njoftojë se asnjë gara nuk po zhvillohet, kur ju të zgjidhni këtë menu.



Benzing Ekspres G2 mund të vlerësojë deri në 8 gara ,të gjitha këto të listuara më poshtë.



Përzgjidhni garën që dëshironi të fshini. Numri i garës së përzgjedhur do të futet në një kornizë të zeze.



Shtypni butonin jeshil "X" për ta fshirë garën.

Gara mund të fshihet vetëm pasi ajo të ketë përfunduar ose të jetë vlerësuar nga qendra.